



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE

V E N D I M

Nr. 634, datë 29.7.2020

PËR

**MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË GRANTIT, NDËRMJET  
KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË  
DHE KONFEDERATËS ZVICERANE, PËR BASHKËPUNIMIN  
NË FUSHËN E REHABILITIMIT TË BANESAVE PAS FATKEQËSISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 19, të ligjit nr.43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtim, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Miratimin e marrëveshjes së grantit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Konfederatës Zvicerane, për bashkëpunimin në fushën e rehabilitimit të banesave pas fatkeqësisë, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në “Fletoren zyrtare”.

K R Y E M I N I S T R I

**EDI RAMA**

**Në mungesë dhe me porosi**

**ZËVENDËSKRYEMINISTRI**

**ERION BRAÇE**

MINISTRI I SHTETIT  
PËR RINDËRTIMIN  
ARBEN AHMETAJ

**Marrëveshje**

**ndërmjet**

**Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë**

**të përfaqësuar nga  
Ministria e Shtetit për Rindërtim**

**dhe**

**Zvicrës  
të përfaqësuar nga  
Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim  
që vepron nëpërmjet  
Ambasadës së Zvicrës në Shqipëri  
për**

**“REHABILITIMIN E BANESAVE NË SHQIPËRI PAS  
TËRMETIT”**

**Për periudhën:**

**14 korrik 2020 deri 31 dhjetor 2021**

Në vijim të përpjekjeve për të fuqizuar marrëdhëniet miqësore që ekzistojnë midis dy Vendeve;

Në përbushje dhe në zbatim të Marrëveshjes Kuadër për Bashkëpunimin Teknik, Financiar dhe Humanitar ndërmjet Këshillit Federal Zviceran dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të nënshkruar më 11 maj 2007;

Në respektim të parimeve demokratike dhe të drejtave themelore të njeriut, të përcaktuara veçanërisht në Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut, e cila frymëzon politikat e brendshme dhe të jashtme të të dy Palëve dhe përbën një element thelbësor së bashku me objektivat e kësaj Marrëveshje;

Qeveria Shqiptare (Përfituesi) i ka paraqitur Konfederatës Zvicerane, nëpërmjet Ambasadës së Zvicrës, një kërkesë për ndihmë financiare lidhur me financimin e rehabilitimit të banesave të dëmtuara nga tërmeti i 26 nëntorit të vitit 2019.

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, i përfaqësuar nga Ministria e Shtetit për Rindërtim (referuar në vijim si "Ministria") dhe Konfederata Zvicerane, e përfaqësuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim, kanë rënë dakord për termat dhe kushtet e mëposhtme:

#### **Neni I Kushtet e Përgjithshme dhe Përkufizimet**

Kudo që janë përdorur në këtë Marrëveshje, termat në vijim do të kenë kuptimet e mëposhtme, përveç kur konteksti e kërkon ndryshe:

1. "Palët Kontraktuese" janë Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Konfederata Zvicerane.
2. "Ministria" është zyra e "Ministrat të Shtetit për Rindërtim".
3. "SDC" është Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim e Departamentit Federal Zviceran të Punëve të Jashtme, e përfaqësuar në Shqipëri nga Ambasada e Zvicrës në Shqipëri.
4. "Projekti" është projekti "Rehabilitimi i Banave në Shqipëri pas tërmetit".
5. "Njësitë Zbatuese" janë bashkitë e Shijakut dhe Kurbinjt, të cilat ngarkohen me zbatimin e Projektit brenda territorit të tyre administrativ.
6. "Komisioni Shtetëror i Rindërtimit" është organi përgjegjës për propozimin e programit të përgjithshëm të rindërtimit dhe për miratimin e burimeve materiale dhe financiare për rehabilitimin dhe rindërtimin e territoreve të prekura nga fatkeqësítë natyrore, si dhe zhvillimin e territoreve të reja.
7. "Përfituesit" janë familjet e zonave të përzgjedhura të dëmtuara nga tërmeti i 26 nëntorit të vitit 2019, banesat e të cilave do të rehabilitohen përmes Grantit të ofruar nga Konfederata Zvicerane.

#### **Neni II Përgjegjësia e Zbatimit**

1. Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë cakton në mirëbesim Ministrinë e Shtetit për Rindërtim si agjencinë homologe të Projektit. Ministria e Shtetit për Rindërtim cakton bashkitë e Shijakut dhe Kurbinjt si Njësitë Zbatuese të Projektit.
2. SDC-ja merr pjesë në përgatitjen, monitorimin dhe drejtimin e Projektit. Për këtë arsy, SDC-ja ia delegon përgjegjësinë e zbatimit Ambasadës së Zvicrës në Shqipëri.

### Neni III Qëllimet dhe Objektivat

1. Qëllimi kryesor i këtij Projekti është të përmirësojë kushtet e jetesës së familjeve (Përfituesve) në zonat e përgjedhura të prekura nga tërmeti i 26 nëntorit të vitit 2019, nëpërmjet riparimit të sigurt të banesave.

2. Rezultatet (objektivat) kryesore të Projektit janë:

**Rezultati 1:** Familjeve në zonat e përgjedhura iu rinovalen banesat e dëmtuara nga tërmeti.

**Rezultati 2:** Masat e rehabilitimit janë në përputhje me standarde e cilësisë, në të njëjtën linjë me vizionin e Qeverisë Shqiptare për strategjinë e rimëkëmbjes "rindërti më mirë".

**Rezultati 3:** Fondet në formën e granteve janë në përpjesëtim me dëmet dhe përdoren me efikasitet, efektshmëri dhe në mënyrë të drejtë.

### Neni IV Objekti i grantit dhe rregullat e këstevë

Konfederata Zvicerane zotohet të japë fonde me vlerë maksimale deri në 164.976.840 lekë (1.428 milionë franga zvicerane) në formën e kontributit me kushtëzim të butë për Planin e Rimëkëmbjes të Qeverisë Shqiptare. Kontributi mbulon të gjitha aktivitetet e rëna dakord midis Palëve, të përshkruara në Shtojcën 1, për periudhën nga data 14 korrik 2020 deri më 31 dhjetor 2021. Kontributi jepet në një këst, si vijon:

- a) Kësti prej 164.976.840 lekë (i barasvlershëm me 1.428 milionë franga zvicerane) transferohet në vitin 2020 pas nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje.

Fondet do të qarkullojnë sipas rregullave dhe procedurave të përcaktuara nga Qeveria Shqiptare, pra sipas sistemit të vendit (shihni Shtojcën 3). Fondet do të shpërndahen në mënyrë të barabartë midis dy bashkive, përkatësisht Shijakut dhe Kurbinjt, sipas listës së përfituesve të miratuar bashkëlidhur Marrëveshjes, duke filluar nga përfituesi i parë deri në shterimin e fondeve.

Njësitë Zbatuese i përdorin fondet në formën e grantit sipas autorizimit të Komisionit Shtetëror të Rindërtimit pas marrjes së miratimit të Këshillit të Ministrave dhe rrjedhimisht, i alokohen Përfituesve sipas nevojave përkatëse financiare, në përputhje me Aktin Normativ "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore" dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.

Nëse pas përfundimit të projektit ka ende fonde të pashpenuara, SDC-ja do të vendosë për përvetësimin e bilancit.

### Neni V Përgjegjësitetë e SDC-së:

- a) SDC-ja i ofron fondet nga granti më lart në përputhje me aktivitetet e rëna dakord nga Palët, të cilat janë pjesë përbërëse e kësaj Marrëveshjeje (shihni Shtojcën 1).
- b) Transferon fondet sipas rregullave dhe procedurave të përcaktuara nga Qeveria Shqiptare, pra sipas sistemit të vendit (shihni Shtojcën 3).
- c) Monitoron zbatimin e skemës së grantit. Dy konsulentët vendas bashkëpunojnë ngushtë me Njësitë Zbatuese për mbikëqyrjen e Bashkive dhe ofrimin e informacionit përkatës për ecurinë e përgjithshme të skemës së grantit, numrit dhe tipologjisë së përfituesve, cilësisë së punimeve, shkallës së suksesit, sfidave të hasura dhe elementeve të tjera.
- d) Ofrimi i asistencës teknike strukturave vendore për sigurimin e cilësisë lidhur me punën e kryer në kuadër të rehabilitimit nga Ndihma Humanitare (NH) Zvicerane,

me qëllim sigurimin se punimet rehabilituese janë kryer në përputhje me standartet e strategjisë "rindërto më mirë" për banesat.

#### **Neni VI Përgjegjësitë e Ministrisë dhe Njësive Zbatuese**

Ministria:

- a) Koordinon zbatimin e skemës së grantit me njësitë zbatuese.
- b) Propozon për miratim pranë Këshillit të Ministrave vendimin përkatës për transferimin e fondeve në formën e grantit për rehabilitim në favor të njësive zbatuese, në vijim të vendimit të Komisionit Shtetëror të Rindërtimit.
- c) Siguron raportimin dhe mbikëqyrjen e përgjithshme të zbatimit të skemës së grantit për rehabilitim.

Njësitë Zbatuese:

- a) Janë përgjegjëse për zbatimin e projektit brenda territorit juridiksional të bashkisë, me qëllim arritjen e rezultateve (objektivave) të projektit në përputhje me Legjislacionin shqiptar, sipas Aktit Normativ "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar në dhjetor të vitit 2019 dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.
- b) Siguron transferimin e fondeve në favor të Përfituesve sipas Vendimit përkatës të Këshillit të Ministrave, bazuar në listën e miratuar të Përfituesve, në përputhje me Aktin Normativ "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", të miratuar në dhjetor të vitit 2019 dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.
- c) Respekton parimet e transparencës dhe llogaridhënieve, si dhe të perspektivës gjinore, mbrojtjes mjedisore, qeverisjes së mirë dhe mbrojtjes sociale për të gjithë palët e interesit.
- d) Siguron qasje në informacionin përkatës, disponueshmérinë e stafit dhe bashkëpunim në të dy bashkitë për qëllime monitorimi.

#### **Neni VII Menaxhimi i Projektit**

Projekti është një sipërmarrje e përbashkët e Ministrisë dhe SDC-së nëpërmjet Ambasadës së Zvicrës në Shqipëri.

Bashkitë e Shijakut dhe Kurbinjt, si Njësi Zbatuese, janë përgjegjëse për zbatimin e Projektit.

Ministria ndërmerr të gjitha veprimet e nevojshme për lehtësimin e zbatimit të aktiviteteve të Projektit, për të cilat është rënë dakord.

Ministria siguron qasjen në informacionin përkatës, duke përfshirë edhe në të dhëna statistikore që çmohen të nevojshme dhe të dobishme për arritjen e objektivave të Projektit. Informacioni përdoret vetëm për qëllimet e Projektit. Për përdorimin e tij për qëllime të tjera, duhet të merret pëlqimi paraprak me shkrim i Ministrit.

#### **Neni VIII Mbikëqyrja dhe Koordinimi**

Për të siguruar mbikëqyrjen dhe koordinimin e përgjithshëm të Projektit, Komiteti Drejtues (KD) mblidhet dy herë gjatë fazës së zbatimit (korrik dhe dhjetor 2020). Vendimet merren me konsensus. Anëtarët e KD-së janë përfaqësues të Ministrit dhe SDC-së, si bashkëkryetarë, si dhe përfaqësues të Bashkive që do të marrin fondet.

Sipas nevojës dhe temës së diskutimit, aktorët e tjerë mund të ftohen që të marrin pjesë në rolin e vëzhguesit.

KD-ja ndërmerr detyrat e mëposhtme:

- a) Që në fillim të projektit, diskuton dhe ndan informacion mbi planin dhe kohëzgjatjen e procedurave lidhur me skemën e grantit për rehabilitim.
- b) Kontrollon ecurinë e zbatimit të projektit bazuar në raportet e monitorimit të përbashkët të bashkive dhe konsulentëve, si dhe kontributet e tjera të Zyrës së Ministrit, kundrejt kuadrit logjik dhe planit të referuar në pikën më lart.
- c) Identifikon, diskuton dhe propozon zgjidhje për probleme të mundshme që mund të lindin gjatë zbatimit të skemës së grantit.

Mund të organizohen mbledhje të paprogramuara, me kërkesë të njërit prej anëtarëve të KD-së.

Komisioni Shtetëror i Rindërtimit informohet mbi vendimet e KD-së. Mbledhjet bashkë kryesohen nga palët kontraktuese.

Palët Kontraktuese e informojnë në kohë njëra-tjetrën, në një shkallë të arsyeshme dhe praktike, si dhe konsultohen me njëra-tjetrën, lidhur me çdo ngjarje, që pengon apo mund të pengojë zbatimin e suksesshëm të Projektit.

#### **Neni IX: E drejta e kontrollit**

SDC, çdo palë e tretë e caktuar prej saj dhe Zyra e Kontrollit Federal Zviceran rezervojnë të drejtën që të vizitojnë kurdoherë kantieret e lindhura me Projektin, të kontrollojnë zbatimin e tij, të marrin informacion dhe të konsultojnë të gjithë dokumentacionin përkatës.

#### **Neni X Raportimi dhe Informimi**

Raportet e Ecurisë përgatiten çdo muaj nga Njësitë Zbatuese në gjuhën angleze dhe dërgohen Ambasadës së Zvicrës në Shqipëri. Të dhënat nga konsulentët mund të ofrohen vetëm me kërkesë.

Ambasadës së Zvicrës në Shqipëri i dërgohen pasqyrat financiare të llogarive së bashku me provat e granteve të transferuara lidhur me skemën e rehabilitimit të financuar në kuadër të Projektit.

#### **Neni XI Monitorimi dhe Vlerësimi**

SDC-ja dhe Ministria mbikëqyrin zbatimin e Projektit.

SDC-ja mund të autorizojë individë dhe organizata të tjera kombëtare apo ndërkombëtare për monitorimin e pjesëve të veçanta të Projektit.

#### **Neni XII Përfituesit dhe Prokurimi**

SDC-ja ia cakton zbatimin e projektit Ministrisë në mënyrë të drejtpërdrejtë, në përputhje me rregullat shqiptare (shihni Shtojcën 3).

Puna ndërtimore/prokurimi i mallrave realizohet drejtpërdrejt nga vetë përfituesi në varësi të nevojave të veta.

Mallrat e siguruara me fondet e SDC-së mbeten në dispozicion të secilit prej Përfituesve në mënyrë të pakufizuar.

### **Neni XIII Klauzola e integritetit**

Brenda kuadrit të kësaj Marrëveshjeje, Palët nuk duhet të propozojnë as në mënyrë të drejtpërdrejtë, as në mënyrë të tèrthortë përfitime të çfarëdolloj natyre. Çdo sjellje korruptuese ose e paligjshme përbën shkelje të kësaj Marrëveshjeje dhe shkak përzgjidhjen e saj, si dhe/ose marrjen e masave korrigjuese shtesë në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm.

### **Neni XIV Zgjidhja e Marrëveshjes**

- 1.1. Nëse njëra nga Palët gjykon se qëllimet e kësaj Marrëveshjeje nuk mund të përm bushen më, ose që Pala tjetër nuk po përbush detyrimet e saj, Pala tjetër ka të drejtë ta anulojë ose zgjidhë këtë Marrëveshje përmes një njoftimi me shkrim tre muaj përpara. Pavarësisht nga sa më sipër, çdo Palë mund ta zgjidhë këtë Marrëveshje me efekt të menjëhershëm në rast të ndonjë shkeljeje thelbësore të Marrëveshjes. Shkelje thelbësore nënku ton shkelje të rendë të një prej objektivave thelbësore të kësaj marrëveshjeje.
- 1.2. Në rast se ngjarjet e forcës madhore (fatkeqësi natyrore, etj.) pengojnë ekzekutimin e kësaj Marrëveshjeje, secila Palë mund ta zgjidhë këtë Marrëveshje që nga momenti kur bëhet i pamundur zbatimi i saj.
2. Në rast zgjidhjeje të parakohshme të kësaj Marrëveshjeje ose në fund të Projektit, çdo fond i pashpenzuar, i ofruar brenda kuadrit të Projektit, i kthehet SDC-së.

### **Neni XV Ndryshimet dhe Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve**

Kjo Marrëveshje mund të ndryshohet në çdo kohë, me pëlqimin e përbashkët me shkrim të Palëve. Ndryshimet hyjnë në fuqi sipas procedurës së parashkruar në pikën 1 të nenit XVIII.

Protokollet Shtesë lidhur me këtë Marrëveshje janë pjesë përbërëse e kësaj Marrëveshjeje. Këto Protokolle Shtesë hyjnë në fuqi sipas po të njëjtës procedurë të parashkruar në pikën 1 të nenit XVIII.

Mosmarrëveshjet që mund të lindin për shkak të interpretimit të kësaj Marrëveshjeje zgjidhen përmes konsultimeve dhe negociatave midis Palëve.

Kjo Marrëveshje zbatohet me kusht që të mos shkelen detyrimet e Palëve lidhur me pronësinë intelektuale sipas marrëveshjeve ndërkombëtare dhe legjislacioneve të tyre kombëtare.

### **Neni XVI Dispozita të përgjithshme**

Brenda kuadrit të kësaj Marrëveshjeje, Palët nuk duhet të propozojnë as në mënyrë të drejtpërdrejtë, as në mënyrë të tèrthortë përfitime të çfarëdolloj natyre. Çdo sjellje korruptuese ose e paligjshme përbën shkelje thelbësore të kësaj Marrëveshjeje dhe shkak përzgjidhjen e saj, si dhe/ose marrjen e masave korrigjuese shtesë në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm.

### **Neni XVII Shtojcat**

Shtojcat e mëposhtme janë pjesë përbërëse e kësaj Marrëveshjeje:

Shtoja 1: Kuadri logjik

Shtoja 2a: Lista e përfituesve, pronarë të banesave individuale në Shijak (sipas pikëzimit)

Shtojca 2b: Lista e përfituesve, pronarë të banesave individuale në Kurbin (sipas pikëzimit)

Shtojca 3: Shënim Procedural për kontributin Zviceran në programin e grantit për rehabilitimin e banesave

### Neni XVIII Kohëzgjatja dhe Efektshmëria

Kjo Marrëveshje hyn në fuqi në datën e marjes së njoftimit të fundit me shkrim, përmes së cilët Palët njoftojnë njëra-tjetrën përmes rrugëve diplomatike përfundimin e procedurave të tyre ligjore kombëtare, të nevojshme për hyrjen e saj në fuqi.

Kjo Marrëveshje hyn në fuqi në datën 14 korrik 2020 dhe është e vlefshme deri më 31 dhjetor 2021. Secila Palë e njofton Palën tjetër me shkrim 3 (tre) muaj përparrë rreth qëllimit të saj për zgjidhjen e kësaj Marrëveshjeje përmes rrugëve diplomatike. Kjo Marrëveshje konsiderohet e rinouar automatikisht për periudhat pasardhëse 1 (një) - vjeçare, përvèçse kur njëra prej Palëve njofton Palën tjetër me shkrim 3 (tre) muaj përparrë datës së përfundimit rreth qëllimit të saj për zgjidhjen e kësaj Marrëveshjeje.

Zgjidhja e kësaj Marrëveshjeje nuk ndikon tek aktivitetet dhe projektet tashmë në proces ose të ekzekutuara.

Kjo Marrëveshje është hartuar në katër kopje origjinale: dy në gjuhën angleze dhe dy në gjuhën shqipe. Në rast mospërputhjesh në interpretim, mbizotëron versioni në gjuhën angleze.

Palët e mëposhtme e konfirmojnë dhe nënshkruajnë këtë Marrëveshje të përpiluar në (...) më(...).


Për Këshillin e Ministrave  
të Republikës së Shqipërisë

Arben Ahmetaj  
Ministër i Shtetit për Rindërtim



Për Konfederatën Zvicerane

Adrian Maître  
Ambasador  
Ambasada e Zvicrës



## Shtoja 1

### Kuadri Logik: Rehabilitimi i banesave pas tërmetit

Hierarkia e objektivave Strategjia e Ndërhyrjes	Treguesit Kyç	Burimet e të Dhënave Mënyrat e Verifikimit	
<b>Ndikimi (Qëllimi i Përgjithshëm)</b> Kushte të përmirësuara jetese përrreth 600 familje në zonat e përzgjedhura, të dëmtuara nga tërmeti, falë banesave të riparuara dhe të sigurta.	<b>Treguesit e Ndikimit</b> Q1. Një kampion burash, grash dhe fëmijësh krahasojnë kushtet e tyre të jetesës përpëra dhe pas tërmetit me ato pas rinnovimit, dhe i vlerësojnë pozitivisht (dhe që të paktën janë njësoj me periudhën përpëra tërmetit). Q2. Vlerësimi i kosto-përfilimit është pozitiv.	<b>Q1.</b> Anketimi i bazuar në kampion pasqyrohet në raportin e misionit të monitorimit (2 konsulentë vendore). <b>Q1.</b> Raportet e bashkive pjesëmarrëse dhe Ministrit të Shtetit për Rindërtim. <b>Q2.</b> Vlerësimi i bazuar në përllogaritje pasqyrohet në raportimin e misionit të monitorimit dhe diskutohet me partnerët kombëtarë.	
Rezultatet	Treguesit e Rezultateve	Faktorët e Jashtëm (Supozimet & Risqet)	
Rezultati 1 Familjet në ..... (Emri/Emrat e bashkisë/bashkive) kanë rehabilituar banesat e tyre të dëmtuara nga tërmeti.	R1.1 Numri i familjeve që kanë passur mundësi të largohen nga strehimet e tyre të përkohshme përpëra ..... (përcaktohet në bazë të zgjedhjes nga ana e bashkisë/bashkive të listave të përfituesve dhe afateve të kontralave të granteve)  Pikësynimi: 600 R1.2 Një kampion prej x% përfituesish, ku gjysma janë gra, dëshmojnë se janë të kënaqur me rinnovimin dhe janë arsyet kryesore pse. Pikësynimi: 90% kënaqshmëri	Raportet e bashkive pjesëmarrëse  Anketimi i bazuar në kampion i pasqyruar në raportet e monitorimit  Raportet e monitorimit të konsulentëve	Vendimi i përfituesve pët-të qëndruar në vendin e tyre nuk ndryshon. Mjetet e jetesës nuk janë në rrezik, dhe për trijedhojë i shtyn njerëzit që të qëndrojnë. Nuk ka disavantazhe të papritura në krahasin me zgjidhje të tjera strehimi apo programe të tjera në zonë.
Rezultati 2 Masat e rinnovimit përbushin	R2.1 % e shtëpisë të riparuara kanë	Inspektimi i bazuar në kampion nga Integrimi i komponentit të	

Hierarkia e objektivave Strategjia e Ndërryres		Treguesit Kyç	Burimet e të Dhënave Mënyrat e Verifikimit
Standardet e cilësisë	zbatuar standardet e rindërtimit më të mirë, sipas përcaktimave të kodeve përkatëse të ndërtimit.	misioni i monitorimit. Raportet e bashkive pjesëmarrëse Raportet e projektit të asistencës teknike (AT) Raportet e Ministrit të Shtetit pë Rindërtim.	asistencës teknike është i realizueshëm. Përfituset shprehin rëndësinë e parimit të "rindërti më mirë" ndaj ekspertëve dhe autoriteteve.
Rezultati 3  Fondet e grantit janë në përpjessëtum të drejtë me dëmet dhe përdoren me efikasitet, efektitshmëri dhe në mënyrë të drejtë.	O3.1 Provat nga monitorimi i punimeve në terren me mospërputhje të konsiderueshme midis grantit dhe dëmeve Pikësynimi: jo më shumë se 10% O3.2 Prova nga monitorimi në terren i rasteve të shpërndajes së pabarabartë/lë padrejtë të granteve O3.3 Përqindja e granteve që janë përdorur siç duhet, sipas termave të kontratës së grantit. Pikësynimi: 90%	Raportet e bashkive pjesëmarrëse Raportet e monitorimit të konsulentëve Anketimet me autoritetet, personat burimorë dhe qytetarët të pasqyrara në raportet e monitorimit O3.1 dhe O3.2 Nëse zbatohet: përfundimet e komisionit shtëror të rindërtimit për sektorin e strehimit të pasqyrara në reportin e monitorimit.	Përfituset e konsiderojnë procesin transparent dhe të drejtë në kuadrin e reagimit të qeverisë ndaj tërmetit dhe e konsiderojnë si pjesë vlerësimit të kushteve të tyre të jetesës.
<b>Përfundimet<sup>1</sup> (sipas rezultateve)</b>		<b>Treguesit e Përfundimeve</b>	
<b>Për Rezultatin 1<sup>2</sup>:</b>			
1 Përfundimi	Familjet marrin grantet e rehabilitimit nga bashkëtë pa probleme dhe në kohë.	Numri i familjeve që marrin grantet përcaktohet gjatë procesit të përzgjedhjes Pikësynimi: 550-600.	Raportet e bashkive pjesëmarrëse Raportet e Ministrit të Shtetit pë Rindërtim Raportet e monitorimit të konsulentëve
2 Përfundimi	Zbatimi i granteve bëhet pa probleme dhe me kosto të kufizuar transaksionesh	Një kampion prej x% të përfitusave déshmon që procesi i kryerjes së punimeve u zbatua relativisht pa	Raportet e bashkive pjesëmarrëse Raportet e monitorimit të konsulentëve Anketimet nga OJF-të dhe/ose

<sup>1</sup> Përkufizimi i Rezultatit 2 dhe përfundimeve, veprimtarive dhe treguesve përkatës janë të papërfunduar, ato do të rishikohen dhe do të përfundohen nga ekipi i Ndihmës Humanitare Zvicerane.

<sup>2</sup> Marrë parasysh llojin e kontributit, zbatimi i këtyre përfundimeve mbetet përgjegjësi e bashkive dhe autoriteteve shqiptare.

Hierarkia e objektivave Strategjia e Ndërhyrjes	Treguesit Kyç	Burimet e të Dhënave Mënyrat e Verifikimit	
	problemë. Pikësynimi: të paktën 70%	autoritetet	
<b>Për Rezultatin 2:</b>			
3 Përfundimi	Personeli përkatesë në bashki (drejtoria e urbanistikës) drejtohen/trajnohen për dytërat e sigurimit të cilësisë (SC) lidhur me punimet e rehabilitimit.	Nr. i personelit të trajnuar dhe drejtoar për të garantuar SC-në e punimeve pikësynimi:(Për t'u përcaktuar; varet nga zgjedhjet përfundimtare të bashkisë(bashkive))	
4 Përfundimi	Përgatiten ose përditësohen dokumentet/vudhëzimet/manuallet përkatese të standardeve të ndërtimit.	Numri dhe lloji i dokumenteve bashkiakë të përditësuara që i përgjigjen dytërave të rindërtimit Pikësynimi: për t'u përcaktuar	
<b>Për Rezultatin 3</b>			
5 Përfundimi	Zbatimi i skemës së granteve për rehabilitimin e banesave monitorohet përkatesisht lidhur me grupin e synuar të kontributit zviceran, përmes një qasjeje bashkëpunimi me personelin e bashkisë.	Informacioni për të gjitha aspektet e zbatimit të skemës së granteve është i disponueshëm dhe ndahet me Autoritetet  Kur është e realizueshme, hartohen raporte të përbashkëta me personelin bashkiak.	Raportet e monitorimit të konsulentëve Raportet e përbashkëta  Personeli bashkiak vihet në dispozicion për dytëra monitorimi dhe është i gatshëm të bashkëpunojë me konsulentët
6 Përfundimi	Përfituesit janë dijeni të detyrimeve që lindin nga përdorimi i granteve dhe i zbatojnë ato, të mbështetur nga bashkite	Një kampion prej x% përfituesish që dëshmojnë se kuptojnë plotësisht dytërimet kontraktuale të grantit Pikësynimi: 70%	Raportet e monitorimit të konsulentëve Anketime nga OJF-të dhe/ose autoritetet  Përfituesit janë gati dhe të afte të bashkëfinancojnë punimet e rehabilitimit dhe të përdorin grantet për qëllimet e duhura
<b>Vëprimtari (për përfundim)</b>		<b>Kontributë</b>	
Lista e vëprimtarive për përfundimin 1:		<ul style="list-style-type: none"> <li>Kontributi zviceran: 1 428 000 Franga Zvicerane</li> </ul>	
<ul style="list-style-type: none"> <li>Bashkitë publikojnë listat e</li> </ul>			

Hierarkia e objektivave Strategjia e Ndërhyrjes	Treguesit Kyç	Burimet e të Dhënavë Mënyrat e Verifikimit
<p>përfitusvese të miratuara nga këshillat bashkakë</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Fondet vihen në dispozicion nga Fondi i Rindërtimit me vendim të KM</li> <li>• Fondet vihen në dispozicion nga kontributi Zviceran</li> <li>• Bashkitë përcaktkojnë kontratat e granteve dhe grantet transferohen në llogaritë bankare.</li> </ul>	<p>Lista e veprimitarive për përfundimin 2:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Përfitusësit kryejnë punimet e rehabilitimit</li> <li>• Përfitusësit identifikojnë dhe kontraktorët e furnitorët përfundimi, riparimin dhe përmirësimin, sipas afateve të përshtatshme me kostot të kufizuar transaksionesh</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Kontributi nga buxheti i shtetit: për t'u përcaktuar në bazë të kërkesave nga bashkëtë</li> </ul>
<p>Lista e veprimitarive për përfundimin 3:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Ekspertët e NH hartojnë dhe zhvillojnë veprimitari trajnuese dhe drejtuese përfundimi (ekspertët vendorë) lidhur me sigurimin e cilësisë së ndërtimit</li> <li>• Trajnuësit zhvillojnë veprimitari trajnuese dhe drejtuese me personelin përkatesë në bashki</li> </ul>		
<p>Lista e veprimitarive për përfundimin 4:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Ekspertët vendorë shqyrtojnë dokumentet/manualat përkatesë përfundimi standardet dhe operacionet e ndërtimit</li> <li>• Ekspertët vendorë mbështesin përditësimin e</li> </ul>		

Hierarkia e objektivave Strategjia e Ndërhyrjes	Treguesit Kyç	Burimet e të Dhënave Mënyrat e Verifikimit
dokumenteve/manualeve përkatëse për standardet dhe operacionet e ndërtimit	<ul style="list-style-type: none"> <li>• 22 000 Franga Zvicerane për 2 ekspertë vendorë</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Konsulentët vendorë vendosin marrëdhëniet bashkëpunimi me personelin përkatës në bashki;</li> <li>• Shqyrtim dokumentacioni përmbledhjen e informacionit lidhur me skemën e grantit</li> <li>• Monitorimi i misioneve në terren, mundësishët së bashku me personelin bashkiak</li> <li>• Anketimet me përfituesit (kampion)</li> <li>• Përpunimi i informacionit dhe hartimi i raporteve të monitorimit (kur është e realizueshme, raporte të përbashkëta me personelin bashkiak)</li> </ul>
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Personeli bashkiak i ofron mbështetje përfituesve për të kuptuar plotësisht të drejtat dhe detyrimet në kuadër të kontratës së grantit</li> </ul>		

## **SHTOJCA 3**

### **Shënim procedural lidhur me kontributin zviceran për programin e Qeverisë së Shqipërisë për grantet për rehabilitimin e banesave, për zbatim brenda vitit 2020**

Kontributi zviceran për programin e granteve për rehabilitimin e banesave synon të përdorë sa më shumë të jetë e mundur sistemin e vendit. Kjo bazohet në bisedat fillestare dhe vullnetin e përbashkët të Ministrisë së Shtetit për Rindërtim dhe Ambasadës së Zvicrës. Kjo procedurë, është ndarë gjithashtu me partnerë të tjerë për zhvillim nga të dy palët.

Qëllimi i këtij shënnimi është të bëjë një pëershkrim të shkurtër të procesit për dorëzimin e angazhimit zviceran për rimëkëmbjen e Shqipërisë pas tërmetit të 26 nëntorit, veçanërisht sa i përket pjesës së "pa përcaktuar" të tij. Gjithashtu, ky shënim, përcakton bazën ligjore dhe marrëveshjet kontraktuale.

#### **Pëershkrim i kontributit/angazhimit zviceran**

Në kuadër të konferencës së donatorëve të organizuar nga BE-ja më 17 shkurt, Zvicra angazhoi një kontribut prej 9 milion Euro (10,24 milion Franga Zvicerane) në formën e mbështetjes me grant për personat e ndikuar nga tërmeti në Shqipëri. Financimi zviceran ndjek që qasje të dyfishtë. Së pari, duhet të trajtohen nevojat immediate në kuadrin e një mekanizmi për financimin e rindërtimit. Së dyti, duhet marrë masa afatmesme për uljen e riskut nga katastrofat, për përgatitjen dhe parandalimin, që do të përfshihen në programet aktuale dhe të reja.

#### **Procesi i rindërtimit/rimëkëmbjes së QSH-së**

Procesi i rindërtimit i përgatitur nga Qeveria e Shqipërisë (QSH) me mbështetjen e donatorëve, përfshin programet e mëposhtme:

1. Ndërtimin e godinave të reja dhe njësive të banimit
2. Grantet për rehabilitimin e godinave të dëmtuara
3. Fondin e strehimit social<sup>1</sup>
4. Rindërtimin e ambienteve dhe infrastrukturës publike
5. Masat e rimëkëmbjes shoqërore dhe ekonomike

Kontributi zviceran i përshkruar në këtë shënim lidhet me programin e dytë të rehabilitimit

Raporti i Vlerësimit të Nevojave Pas Katastrofës (VNPK) siguron një vlerësim (paraprak) të detajuar të dëmeve dhe nevojave për rindërtim në sektorë të ndryshëm, që janë renditur nga Qeveria sipas përparësisë në programet e rindërtimit dhe aktet ligjore dhe nënligjore përkatëse.

Dy komponentët kryesorë të planit të rimëkëmbjes janë "Akti për Përballimin e Pasojave të Fatkeqësisë Natyrore" (dhjetor 2019) dhe "Fondi i Rindërtimit" pjesë e buxhetit të shtetit për vitin 2020 (160 milion Euro). Mekanizmi financier i krijuar nga QSH bazohet në kuadrin ligjor të procesit të rindërtimit me qëllim financimin e rimëkëmbjes pas fatkeqësisë dhe operacioneve të rindërtimit dhe për të ndihmuar në përdorimin e përshtatshëm dhe në kohë të burimeve të mobilizuara. Kontributet mund të bëhen në çdo prej sektorëve të identifikuar në VNPK dhe mund të bëhen në nivel kombëtar apo vendor, në përputhje me përparësitë e qeverisë. Përcaktimi i kontributeve mund të bëhet ose sipas sektorit, ose sipas mbulimit gjeografik.

Për sa i përket organizimit të zbatimit të planit të rimëkëmbjes, Komisioni Shtetëror i Rindërtimit u krijua nga QSH si organi përgjegjës për propozimin e një programi të përgjithshëm rindërtimi dhe për miratimin e burimeve materiale dhe financiare për

<sup>1</sup> Nuk bën pjesë në Fondin e Rindërtimit

rimëkëmbjen dhe rindërtimin e territoreve të ndikuara nga fatkeqësitetë natyrore, si dhe për zhvillimin e zonave të reja urbane, sociale dhe ekonomike. Ministri i Shtetit për Rindërtim u krijua si organi përgjegjës për bashkërendimin me institucionet vendore dhe ndërkombëtare të përfshira në procesin e rindërtimit.

#### Grantet e rehabilitimit për godinat e dëmtuara (Programi i Granteve): sistemi i vendit

Bazuar në Aktin Normativ "Për Përballimin e Pasojave të Fatkeqësisë Natyrore" të miratuar në dhjetor 2019, Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 5, datë 6.1.2020 (i ndryshuar) përcakton rregullat dhe procedurat e pranimit për fonde rindërtimi dhe projekte model, përfshirë grantet e rindërtimit për godinat e dëmtuara (banesa individuale apo godina kolektive) që nuk kanë nevojë të shemben. Subjektet përfituese janë individët dhe familjet, të cilët kanë humbur një ose më shumë anëtarë të familjes dhe/ose kanë mbetur të pastrehë dhe/ose kanë pësuar dëme në banesat ose shtëpitë individuale të banimit, si pasojë e fatkeqësisë natyrore, në njësitë e vetëqeverisjes vendore ku është shpallur gjendja e fatkeqësisë natyrore si dhe të gjitha subjektet e tjera.

Sa i përket programit të granteve të rehabilitimit, bashkitë janë njësitë zbatuese përgjegjëse për administrimin e fondeve të shpërndara për këtë qëllim nga Fondi i Rindërtimit. Bashkitë kanë rolin kryesor të vlerësimit të dëmeve të aplikantëve, përzgjedhjes së përfituesve në bazë të kritereve të përcaktuara dhe transferimit të fondeve drejtpërsëdrejti tek përfituesit.

Shuma e saktë e grantit për secilin përfitues përcaktohet në vendimin përkatës së këshillit bashkiak, sipas tre kategorive të dëmit (DS: shkalla e dëmit) por jo më shumë se 100 000 Lek për DS1 (800 Euro), 250 000 Lek për DS2 (2 000) Euro dhe 500 000 Lek për DS3 (4 000 Euro). Vlerësimi i aplikimeve bëhet nga një komision i posaçëm vlerësimi i ngritur në çdo bashki, bazuar në një sërë kriteresh dhe dokumentacionin e nevojshëm të bashkëngjitur për verifikimin e dëmit. Bashkitë kanë detyrimin që këto t'i bëjnë transparente dhe të aksesueshme. Kriteret për përparësisë për renditjen e përfituesve janë si vijon: a) familjet që kanë humbur familjarët nga fatkeqësia natyrore; b) familjet njëprindërore që kanë në ngarkim fëmijë, ku përfshihen edhe vajzat nëna; c) familjet që kanë në përbërje persona me aftësi të kufizuara; ç) të moshuarit, të cilët kanë mbushur moshën e pensionit; d) familjet në skemën e ndihmës ekonomike; dh) të rënët në krye të detyrës. Këshilli bashkiak miraton listën përfundimtare të përfituesve të përzgjedhur bazuar në raportin e vlerësimit të dorëzuar nga komisioni i posaçëm.

Transferimi i fondeve për grantet e rehabilitimit nga Buxheti i Shtetit (Fondi i Rindërtimit) drejt bashkive bëhet me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të Ministrit të Shtetit për Rindërtim, dhe sipas listave të përfituesve të kualifikuar. Fondet i transferohen përfituesve në llogaritë e tyre bankare nga ana e bashkisë jo më vonë se 10 ditë nga nënshkrimi i kontratës së grantit midis përfituesit dhe bashkisë.

Gjithsej, ka pasur 26 246 aplikime në internet për grante rehabilitimi (DS1-DS2-DS3). Kosto e parashikuar e të gjithë programit të granteve të rehabilitimit është rreth 60 milion Euro (63,5 milion Franga Zvicerane). Qeveria e Shqipërisë mbulon koston e të gjithë programit të granteve të rehabilitimit duke përdorur kontributin zviceran. I gjithë programi i granteve për rehabilitim mbulon të gjithë aplikantët e kualifikuar.

#### Kontributi zviceran për Programin e Granteve të Banesave

Në kuadër të angazhimit, kontributi i drejtpërdrejtë i Zvicrës për grantet e rehabilitimit të ndërtësave të dëmtuara është 1 450 000 Franga Zvicerane, nga të cilat 1 428 000 Franga Zvicerane (164 976 840 Lek) janë për grante dhe 22 000 Franga Zvicerane për qëllimet e monitorimit të zbatimit të kontributit. Synimi është jepet ndihmë për lehtësimin e vështirësive të hasura nga qindra familje si pasojë e tërmetit, duke i ndihmuar ata t'i rikthehen gradualisht "normalitetit", duke siguruar banesën ku jetojnë dhe duke mos qenë të detyruar të shpërngulen në zona të tjera. Në mënyrë të veçantë, mbështetja u jepet dy bashkive të Shijakut dhe Kurbinjt. Ky "kontribut me kushtëzim të butë" gjeografik bazohet në parimin e plotësimit dhe vijimit të mbështetjes së mëparshme të siguruar përmes programit Strehimi (Shelter), reagimit për emergjencën nga ana e Ndihmës Humanitare Zvicerane menjëherë

pas tërmetit. Numri i aplikimeve për skemën e grantit<sup>2</sup> ishte 2 815 në Shijak (1 174 të kualifikuar për grante për banesa individuale) dhe 2 360 në Kurbin (1 651 të kualifikuar për grante për banesa individuale). Kontributi zviceran do të mbështesë 228 përfitues të banesave individuale në Shijak (nga numri 1 deri në 228 të listës në Shtojcën 2a të Marrëveshjes) dhe 332 përfitues të banesave individuale në Kurbin (nga numri 1 deri në 332 të listës në Shtojcën 2b të Marrëveshjes).

Kontributi zviceran prej 1,45 milionë Franga Zvicerane plotëson financimin e Qeverisë së Shqipërisë për Programin e Granteve, të siguruar përmes Fondit të Rindërtimit. Fondet do ti vihen në dispozicion përfituesve fundorë përmes procedurave të përcaktuara nga QSH për këtë program, duke përdorur plotësish sistemin e vendit. I gjithë zbatimi i skemës së granteve do të jetë përgjegjësi e autoriteteve shqiptare. Më poshtë jepet një përshkrim i shkurtër. Përtej kësaj, Zvicra po shqyrt俊 mundësi për të mbështetur autoritetet me zbatimin e parimeve të "rindërtojmë më mirë", edhe në kuadër të granteve të rehabilitimit, ashtu siç parashikohet në Rezultatin 2 të kësaj Marrëveshje.

#### Organizimi ligjor dhe administrativ i kontributit zviceran

Baza ligjore për sigurimin e kontributit zviceran është marrëveshja e projektit/granteve midis Qeverisë së Shqipërisë dhe Zvicrës, përfaqësuar përkatësisht nga Ministri i Shtetit për Rindërtim (Ministri) dhe Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC). Marrëveshja përcakton se fondet do të transferohen në Fondin e Rindërtimit (Buxheti i Shtetit) dhe më pas i shpërndahen njësive zbatuese (bashkive), sipas rregullave dhe procedurave të përcaktuara nga Qeveria e Shqipërisë.

#### Mbikëqyrja dhe Raportimi

Procesi mbikëqyret nga një organ drejtues i përbërë nga përfaqësues të të gjitha palëve (Ambasada e Zvicrës, Ministri i Shtetit për Rindërtim, bashkitë). Komisioni Shtetëror i Rindërtimit do të informohet për vendimet e marra nga organi drejtues.

Kërkesa e përgjithshme për Programin e Granteve (nuk lidhet me kontributin zviceran) është se informacioni për ecurinë përgatitet nga Njësità Zbatuese çdo muaj. Për qëllimet e monitorimit të Zvicrës, një pjesë e vogël e kontributit (22 000 Franga Zvicerane) do të përdoret për angazhimin e ekspertizës së jashtme të monitorimit, që do të ketë detyrë të sigurojë informacionet përkatëse për ecurinë e skemës së granteve, numrin dhe tipologjinë e përfituesve, cilësinë e përgjithshme të punimeve, shkallën e suksesit, sfidat e hasura, si dhe elementë të tjera. Ekspertët e monitorimit i raportojnë Ambasadës së Zvicrës dhe organit drejtues. Informacioni i siguruar nga ekspertët e monitorimit mund të vihet në dispozicion me kërkësë të bashkive për detyrat e tyre të raportimit. Pasqyrat financiare të llogarive me prova të granteve të transferuara që lidhen me skemën e rehabilitimit të financuar në kuadër të Projektit i dërgohen Ambasadës së Zvicrës.

SDC-ja, çdo palë e tretë e caktuar prej saj, dhe Zyra e Auditit të Brendshëm të Departamentit Federal Zviceran për Punët e Jashtme ose Kontrollit Federal Zviceran të Financave, kanë të drejtën të vizitojnë në çdo moment pikat që lidhen me Projektin, të kontrollojnë zbatimin e tij, të marrin informacion dhe të konsultojnë të gjithë dokumentacionin përkatës të administruar si nga Qeverisja apo Administrata Qendrore dhe Vendore.

<sup>2</sup> Banesa individuale dhe godina kolektive)

NR.PROT. 3789/1  
DATË 4, 8, 2020

MINISTRIT TË SHTETIT PËR RINDËRIMIN  
QENDRËS SË BOTIMEVE ZYRTARE

Sekretari i Përgjithshëm

Engjell AGACI

